



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.038/2016

Prishtinë, më 31 gusht 2016

PROCESVERBAL

Mbledhjen e kryesoi Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit FunkSIONAL.

Në mbledhje morën pjesë: Salihe Mustafa, Nenad RashiQ, Mexhide Mjaku-Topalli, Mytaher Haskuka,dhe Kujtim Paçaku.

Munguan: Etem Arifi, Valdete Bajrami dhe Teuta Haxhiu.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Alketa Lasku-TDH, Flora Kryeziu - UNICEF, Valdrin Dervishaj-UNICEF, Sanije Berisha-OSBE, Ramadan Troni- përfaqësues ish-punëtorëve të Ndërmarrjes shoqërore “Sharr-Sallonit” nga Hani i Elezit, Valon Hasani-Interlex associates dhe Bejtush Isufi- Interlex associates.

Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit, fillimisht kërkoi falje për fillimin me vonesë të kësaj mbledhjeje dhe i hapi punimet e mbledhjes së sotme, sipas propozimit të rendit të ditës, të paraqitur dhe të dërguar anëtarëve të Komisionit.

Anëtarët e Komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e Komisionit FunkSIONAL, ndërsa në vazhdim Komisioni i zhvilloi punimet me këtë rend dite:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme;
2. Shqyrtimi i ankesës së ish- punëtorëve të Ndërmarrjes shoqërore “Sharr-Sallonit” nga Hani i Elezit. Të ftuar: përfaqësuesit e ish-punëtorëve të ndërmarrjes dhe avokati i tyre.
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme

Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve, të mbajtura më datë 30 qershor 2016 dhe 12 korrik 2016.

2. Shqyrtimi i ankesës së ish- punëtorëve të Ndërmarrjes shoqërore “Sharr-Sallonit” nga Hani i Elezit. Të ftuar: përfaqësuesit e ish-punëtorëve të ndërmarrjes dhe avokati i tyre.

Kryetarja, Lirije Kajtazi, tha se për ankesën e ish-punëtorëve të Ndërmarrjes shoqërore “Sharr-Sallonit” nga Hani i Elezit, si Komision patëm vendosur për t’i ftuar në takim përfaqësuesit e kësaj ndërmarrjeje, në lidhje me kërkesat e tyre.

Përfaqësuesit e atyre punëtorëve i kemi këtu së bashku me avokatin e tyre dhe do t’i dëgjojmë brengat e tyre.

Bejtush Isufi, avokat i ish-punëtorëve të Ndërmarrjes shoqërore “Sharr-Sallonit” nga Hani i Elezit.

Fillimisht, para Komisionit përshkroi kushtet e vështira, në të cilat kanë punuar ata punëtorë, ku punua e tyre kishte të bënte me një material i cili është vlerësuar i rrezikshëm dhe kancerogjen, edhe me konventa ndërkombëtare, e sidomos në Bashkimin Evropian është bërë ndalimi i tij dhe kjo ka qenë edhe arsyeja që shtylla e katërt e UNMIK-ut, me një vendim të veçantë, ka mbyllur këtë ndërmarrje.

AKP-ja i ka pranuar kërkesat e punëtorëve të “Sharr Salonitit” për kompensim, për shkak të pasojave jetësore dhe shëndetësore dhe për shkak se një numër i punëtorëve tashmë kanë vdekur, një pjesë e madhe nga sëmundja e kancerit, me qindra janë diagnostikuar dhe janë të sëmurë me kancer, si pasojë e azbestit, prandaj kërkesa e jonë për komisionin është shumë e thjeshtë, pra kërkojmë që ato vendime që i ka miratuar AKP-ja, për kompensim të secilit punëtor, të realizohen.

Po ashtu, kërkojmë që AKP-ja, mos t’i trajtojë ish-punëtorët e kësaj ndërmarrjeje, sikur punëtorët tjerë. Pra, nëse vonohet pagesa e këtyre punëtorëve, pasojat do të jenë drejtpërdrejt për familjet, sepse një pjesë e këtyre familjeve nuk do të kenë mundësi në pagimin e barnave dhe anëtarët e tyre do të vdesin para kohe, për shkak te papërgjegjësisë së Bordit të AKP-së.

Ligji e obligon AKP-në, për të bërë ekzekutimin e këtyre mjeteve. Po ashtu, tha se beson që me një angazhim të këtij komisioni dhe me një bisedë me Bordin e AKP-së, kjo çështje do të zgjidhet, sepse është e thjeshtë dhe kërkoj edhe një herë gatishmërinë dhe vullnetin e anëtarëve të Komisionit Funkcional, lidhur me këtë çështje.

Ramadan Troni, përfaqësues ish-punëtorëve të Ndërmarrjes shoqërore “Sharr-Sallonit” nga Hani i Elezit.

Në fillim të fjalës së tij, tregoi dhe shfaqti brengosje, siç tha ai, gjendjen shëndetësore alarmante të këtyre ish-punëtorëve.

Pretendues janë 389 punëtorë që kanë aplikuar, mbas privatizimit të ndërmarrjes, në mesin e tyre nuk janë 70.

Ai më pas prezantoi edhe një historik që nga funksionimi i kësaj ndërmarrjeje, që nga viti 1974.

Në vitin 2006, me vendim të shtyllës së katërt të UNMIK-ut, na është urdhëruar të bëhet dekontaminimi e të gjitha pajisjeve.

Në vitin 2010, është vendosur për privatizimin e ndërmarrjes, Komiteti i Likuidimit e ka kryer punën në mënyrë profesionale. Ne nuk kërkojmë nga AKP-ja asgjë më shumë se sa atë që e thotë ligji, ndërsa vendimet duhet të bëhen në bazë të atij ligji.

Kryetarja, pyeti se a keni pasur takim me Bordin e ri të AKP-së, me Avokatin e Popullit dhe a është evidentuar ky problem?

Bejtush Isufi, theksoi se kemi pasur një premtim nga administrata e AKP-së, se bordi do të na ftojë në një takim, por kjo ende nuk ka ndodhur.

Salihe Mustafa, tha se si komision i kemi marrë shumë seriozisht problemet, me të cilat ballafaqohen këta punëtorë. Njëra nga koleget tona e ka ngritur këtë çështje edhe në Kuvend, në formë të pyetjes parlamentare.

Ne, si komision do t'i takojmë edhe përfaqësuesit e AKP-së, sa më shpejt që është e mundur dhe premtoi për angazhim të përbashkët në zgjidhjen e këtij problemi.

Kujtim Paçaku, tha se nga ajo që dëgjuam rezulton se situata është alarmante. Është dashur që të intervenohet më herët dhe të vijë deri te një zgjidhje. Po ashtu, ka qenë mirë të jenë edhe përfaqësuesit e AKP-së dhe t'i dëgjojmë edhe mendimet e tyre, po në këtë takim.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se këtë çështje e ka ngritur edhe në Kuvend, duke kërkuar nga Qeveria që të intervenojë AKP-ja rreth një ndarje të buxhetit, pikërisht për shërim, mirëpo ende nuk kemi marrë asnjë përgjigje, mirëpo me këmbëngulje do të kërkojmë një zgjidhje për këtë çështje. Ajo pyeti se çka do të bëhet me ato familje, të cilave ju kanë vdekur anëtarët e familjes, a do t'i marrin mjetet ata familjarë që iu kanë takuar atyre personave, e që nuk janë më në jetë, a është bërë ndonjë vlerësim i ambientit ndonjëherë në "Sharr Salonit", dhe se çka kuptohet me rentën jetësore?

Ramadan Troni, tha se janë 70 punëtorë të vdekur, që nga ajo kohë e deri më tani.

Komiteti i Likuidimit ka mundur të aplikojnë trashëgimtarët e familjeve të tyre.

Në vitin 2001 dhe 2002, kur ka qenë shtylla e katërt e UNMIK-ut, kanë vlerësuar se ndotja është 100 herë më e lartë se që është e lejuar.

Mexhide Mjaku-Topalli, kërkoi të dijë se eksportuesi ka qenë i obliguar të ndajë një shumë të mjeteve, për shkak të rrezikshmërisë që ka pasur azbesti dhe se ku janë ato mjete.

Ramadan Troni, theksoi se ai është Fondi për mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve, i cili shërben për asgjësimin e produkteve të azbestit. Në vazhdim, ai theksoi se tenderin për këtë çështje e

ka fituar një firmë, e cila ka marrë grande nga BE-ja për ndërrimin e gypave të azbest-çimentos.

Valon Hasani, theksoi se njëra nga detyrimet e tyre ka qenë kompensimi i dëmeve shëndetësore të shkaktuara ndaj punëtorëve.

Lirije Kajtazi, tha se do të analizojnë mënyrën e kontaktimit me AKP-në, në mënyrë të sqarimit dhe zgjidhjes së kësaj çështjeje.

Mexhide Mjaku – Topalli, propozoi që të thirren përfaqësuesit e AKP-së, në mënyrë që të marrin përgjigje prej tyre dhe të vendosin për këtë rast.

Në fund, Komisioni FunkSIONAL vendosi që në takimin e radhës të vendoset se kur do të thirren përfaqësuesit e AKP-së, për të diskutuar për këtë çështje.

3. Të ndryshme

Lirije Kajtazi, në lidhje me procesin e shqyrtimit dhe amendamentimit të Projektligjit për mbrojtjen e fëmijës, tha se është konsultuar edhe me subjektet e tjera që janë të interesuar për këtë çështje dhe është dakorduar, që në takim të ftohet edhe ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, andaj propozoi mbajtjen e një dëgjimit publik për këtë projektligj. Ajo, po ashtu, i pyeti se a dëshirojnë anëtarët e Komisionit që të formojnë grup të punës për këtë çështje.

Në fund, Komisioni FunkSIONAL vendosi që të gjithë anëtarët e Komisionit të punojnë në këtë projektligj, pa formuar grup të veçantë punues.

Mytaher Haskuka, kërkoi informacione se a do të jenë përfaqësuesit e MPMS-së në dëgjim publik, për të dhënë sqarime për mendimet e tyre që kanë dhënë për Projektligjin për mbrojtjen e fëmijës.

Në fund, Komisioni FunkSIONAL vendosi që dëgjimi publik të mbahet brenda këtyre dy javëve, në mënyrë që të respektohen procedurat e Kuvendit.

Lirije Kajtazi, më pas i njoftoi anëtarët e Komisionit për takimin që ka pasur me Komisionin Qeveritar për Personat e Pagjetur. Ajo theksoi se pasi që të mbahet edhe një takim me këtë Komision, do të përcaktohen për një vendim për nismën legislative për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për personat e pagjetur.

Mytaher Haskuka, kërkoi nga anëtarët e Komisionit, që të marrin vendim për të ftuar ministrin e Punëve të Brendshme, për të dhënë sqarime rreth rasteve të arrestimeve të fundit, ku janë bastisur shtëpitë dhe kanë ndodhur arrestime, pa pasur vendime të formës së shkruar nga ana e gjykatës.

Ai tha se policia, pa vendim me shkrim, kanë hyrë në shtëpitë e personave civilë, duke i maltretuar dhe terrorizuar dhe duke i mbajtur pa arsye dhe duke mos i lejuar që të kontaktojnë me avokatët e tyre.

Po ashtu, ai përmendi edhe disa shkelje të tjera që kanë ndodhur gjatë këtyre proceseve të arrestimeve dhe marrjes në pyetje të të arrestuarve. Ai tha se arrestimet pa vendime të formës së shkruar dhe mbajtja në izolim, janë shkelje të të drejtave të njeriut.

Për të gjitha këto, ai kërkoi miratimin e Komisionit, për të ftuar në takim ministrin e Punëve të Brendshme, për të dhënë sqarime rreth këtyre rasteve. Po ashtu, ai tha se organizata

ndërkombëtare “Amnesty International”, ka theksuar se hyrja dhe bastisja e zyrave të Lëvizjes Vetëvendosjes, përbën shkelje të të drejtave të njeriut dhe kërkohet që të bëhet hetim më i theksuar në këtë drejtim. Për këtë, ai tha se nuk është ndërmarrë asnjë veprim deri tani.

Lirije Kajtazi, duke u ndërlidhur me këtë çështje, kërkoi nga anëtari i Komisionit, z. Mytaher Haskuka, që të kursehet nga fyerjet e përdorura në atë diskutim.

Po ashtu, ajo theksoi se duke pasur parasysh që procesi për këtë çështje është në zhvillim e sipër, ata nuk mund të ndërhyjnë në këtë rast, pasi që ka dëme dhe vepra të dhunshme në shumë drejtime, andaj hetuesia duhet të veprojë, në raste të tilla dhe nuk është në rregull që të ndërhyhet në këto momente. Ajo ishte e pajtimit që të ftohet ministri i Punëve të Brendshme, mirëpo në një kohë më të përshtatshme dhe jo tani.

Mytaher Haskuka, theksoi se nuk është politike që të kërkohen informacione për disa çështje esenciale, për të cilat janë shkelur të drejtat e njeriut.

Në fund, u vendos që në një fazë tjetër, të thirret ministri i Punëve të Brendshme, në Komision.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 15:00.

Kryetarja e Komisionit

Lirije KAJTAZI

*Procesverbalin e hartoi:
Stafi mbështetës i Komisionit.*